

**AKT THEMELIMI DHESTATUTI I  
"IMTC" SHPK**

## **EMËRTIMI-SELIA- KOHËZGJATJA**

Neni 1.

### **KRIJIMI, EMËRTIMI I SHOQËRISË.**

1.1 Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **IMTC - International Military Trade and Consulting** në vijim e quajtur "Shoqëria".

1.2 Shoqëria themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, identifikuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 2.

**SELIA**

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën : - Rruga Ismail Qemali , Pallati 18 ,Apt 14/2, Tirane, Shqiperi

2.2 Me vendim të Asamblese së Ortakëve mund të hapë zyra përfaqesie, degë, dhe/ose të krijoje filiale brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 3.

### **KOHËZGJATJA**

3.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të papërcaktuar,në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi,duke filluar nga rregjistrimi i saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 4.

### **OBJEKTI I SHOQËRISË**

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me pernjë me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në vecanti:

- Kryerje e aktivitetit të import ,eksport, transferim kombtar dhe nerkometar te mallrave ushtarake.
- Eksportim dhe importim, me shumice edhe pakice edhe ose depozitim e mallrave dhe nenprodukteve te cdo lloji ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi.
- Kryerje konsulenca financiare dhe teknike , studime per tregjet si dhe kryerja e cdo aktiviteti te lejuar nga legjislacioni per shoqerite tregtare.
-

**KAPITALI**  
**PASURIA DHE FINANCIMI I SHOQERISE**

**NENI 5**

**KAPITALI THEMELTAR.**

**5.1** Kapitali themeltar eshte 100 lek i ndare ne 1 (nje ) kuote me vlore 100 leke .Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet ne perputhje me legjisacionin ne fuqi.

**NENI6**

**ORTAKËT.**

6.1 Kapitali i shoqerise zoterohet 100% nga ortaku Z.\_Nertil Qazimi shtetas shqiptar ,i biri i Çelnik , lindur me date 19.11.1986 , ne Shkozanj , Korçe identifikuar me ID 032934243 , madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar.

**NENI7.**

**TRANSFERIMI I KUOTAVE.**

**7.1** Kuotat jane lirisht te transferueshme me miratim paraprak te asamblese se ortakeve.

**7.2** Transferimi i kuotave duhet te realizohet ne perputhje me ligjin dhe te regjistrohet ne QKB sipas parashikimeve ligjore.

**NENI 8.**

**FINANCIMI I SHOQËRISË.**

**8.1.** Shoqëria me qëllim arritjen e objektivit të saj, do të kërkoje financimin nëpermjet mënyrave ligjore :- si kredi bankare, hua, financim nga ortakët dhe çdo forme tjetër ligjore.

**NENI 9.**

**ORGANET E SHOQËRISË.**

**9.1** Organet e Shoqërise janë:

- Administratori,
- Asambleja e Ortakëve.

**NENI 10.**  
**ADMINISTRATORËT**  
**FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT.**

**10.1** Shoqeria administrohet nga 1 (nje)Administrator. Administratori është i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet tregtare të shoqerise pa kufizim kompetencash, përvec atyre që ligji, akti i themelimit dhe statuti ja ngarkon Asambleë së Ortakeve.

**10.2** Administratori i shoqerise kryen administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise. Shoqeria ka si administrator Z. Nertil Qazimi shtetasi shqiptar ,i biri i Çelnik , lindur me date 19.11.1986 , ne Shkozanj, Korçe , identifikuar me ID 032934243 , madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar.

**10.3** Administratori ka te gjitha kompetencat per të perfaqesuar shoqerine ne marredhenie me te tretet. Ai vepron ne emer te shoqerise dhe nenshkruan cdo dokument te shoqerise. Administratori nuk ushtron kompetencat qe ligji ose aktet e shoqerise ja jepin shprehimisht Asamblese se Ortakeve. Administratori emerohet per nje afat 3 vjecar me te drejtë rizgjedhje.

**10.4** Administratori mund te autorizoj nje person te kryeje veprim ne QKB si depozitim aktesh, vendimesh, bilance, statutit dhe cdo akt e tjeter.

**10.5.** Administratori perfiton shperblim/pagesa per punen e tyre ne masen e percaktuar me vendim te asamblese se ortakeve

**NENI 11.**  
**ASAMBLEJA E ORTAKËVE**

**11.1.** Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise dhe vendos per cdo ceshtje qe ligji ose ky statut ia rezervon asaj.Vendimet e Asamblese jane te detyrueshme te zbatohen nga organet e shoqerise.

**11.2.** Mbledhjete Asamblese se Ortakeve organizohen ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

**11.3.** Asambleja zhvillohet ne menyre te rregullt dhe vendos ne menyre te rregullt sipas kuorumi te parashikuar nga ligji.

**11.4.** Mbledhje te Asamblese zhvillohen normalisht ne seline e shoqerise por, me vendim te saj Asambleja mund te mblidhet edhe ne nje vend tjeter brenda ose jashte Shqiperise.

**11.5.** Ortaket njoftohen per mbledhje ne asamblese te pakten 7 (shtatë) dite perpara dhe duhet te marrin njoftimin per daten, oren, vendin, rendin e dites dhe te marrin kopjen e dokumenteve qe lidhen me rendin e dites.

**11.6.** Mbledhjet e Asamblese se Ortakeve mund te thirren nga Administratori / administratoret, ose nga subjektet e parashikuara ne ligj.

**NENI12.**

**VITI FINANCIAR.**

**12.1.** Viti finanziar i shoqerise fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

**12.2.** Bilanci i shoqerise mbahet ne perputhje me ligjin, miratimi dhe cdo veprim tjeter merret ne perputhje me parashikimet ligjore.

**NENI 13.**

**PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË.**

**13.1.** Procedura e likuidimit e parashikuar ne ligjin nr. 9901, date 22.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" zbatohet ne rastin e prishjes se shoqerise.

**13.2.** Shoqeria prishet ne rastet e meposhteme : me vendim te asamblese; me hapjen e procedurave te falimentimit; me vendim gjykate; dhe per cdo arsyte tjeter parashikuar ne aktet e shoqerise ose ne legjislacionin shqiptar.

**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**NENI 14.**

**LIGJI I ZBATUESHËM.**

**14.1.** Shoqeria do te kryeje veprimtarine e saj neperputhje me kete statut dhe me parashikimet e ligeve shqiptare. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut do te zbatohet ligji shqiptar nr. 9901 , date 22.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

**14.2.** Ky akt themelimi dhe statut hartohet dhe nenshkruehet ne 5 kopje origjinale sot me 17/12/2018 , ne Tirane.

**Për subjektin " IMTC " SHPK**

 Ortaku NERTIL QAZIMI

